

URDHËR
Nr. 1, datë 25.9.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. Ledina Beqiraj Agalliu, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Mjedisit.
 2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Mjedisit, do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri më datë 31 dhjetor 2025.
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.
 4. Urdhri nr. 1, datë 6.1.2025, “Për delegimin e kompetencave”, të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj